



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

PROCESI I ÇMUARJES SË PROVAVE DHE KRIJIMI I BINDJES PËRTEJ ÇDO DYSHIMI TË ARSYESHËM

Eneja Allmuça*, Eldorado Aga**

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Përmbledhje

Në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Një sistem juridik i konsoliduar duhet të garantojë efektivisht këtë parim. Ky parim pasqyron vlerën e lartë shoqërore të sigurisë dhe lirisë personale në një shtet të së drejtës.

Qëllimi i trajtimit të kësaj teme është pikërisht nxjerrja në pah e rëndësisë së këtij parimi si një nevojë për garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Ky punim synon t'i japë një perceptim ndryshe konceptit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” si dhe të analizojë kriteret kryesorë mbi të cilët bazohen gjykatat. Ky punim do të evidentojë qasjet teorike dhe krahasimore midis dy sistemeve kryesore juridike.

Punimi ka si qëllim që t'u japë përgjigje një sërë pyetjesh siç janë: “Çfarë kuptojmë me konceptin “tej çdo dyshimi të arsyeshëm; Çfarë rëndësie ka një provë e vetme lidhur me provimin e fajësisë së të pandehurit; Çfarë ndikimi kanë “indicjet” gjatë procesit të çmuarjes së provave dhe krijimit të bindjes së brendshme të gjyqtarit si dhe cilat të drejta kushtetuese implikon aplikimi i këtij parimi?”

Duke marrë parasysh temën e punimit, është dashur fillimisht të identifikoheshin materialet specifike të fushës, që lidhen me akte ligjore, manuale apo komentare, bibliografi vendase dhe e huaj, konsultimi i burimeve elektronike dhe praktikave gjyqësore vendase dhe të huaja. Gjatë punimit janë përdorur metodologji të ndryshme studimore, si metodologjia e analizës së rasteve, e sintezës dhe metodologjia krahasuese.

Fjalë çelës: *tej dyshimit të arsyeshëm, bindja e brendshme, indicjet, procesi i rregullt ligjor, vlera e provave, prezumimi i pafajësisë.*

THE PROCESS OF VALUING EVIDENCE AND ESTABLISHING CONVICTION BEYOND REASONABLE DOUBT

Abstract

In criminal proceedings, the prosecution is required to prove, beyond any reasonable doubt, any element that constitutes the criminal offense for which the defendant is accused. A consolidated legal

system must effectively guarantee this principle. This principle reflects the high social value of security and personal freedom in a rule of law state.

The purpose of addressing this topic is precisely to highlight the importance of this principle as a need to guarantee a fair legal process. This paper aims to give a precise definition of the concept “beyond any reasonable doubt” and to analyze the main criteria on which the courts are based. This paper will highlight the theoretical and comparative approaches between the two main legal systems.

This paper aims to answer a series of questions such as: “What do we mean by the concept “beyond any reasonable doubt; what importance does a single evidence have in relation to the defendant’s guilt test; what impact does “indications” have on the process of assessing evidence and establishing the judge’s internal conviction, and what constitutional rights does the application of this principle imply?”

In view of the topic of the paper, it was initially necessary to identify the specific materials of the field, related to legal acts, manuals or commentaries, domestic and foreign bibliography, consultation of electronic resources and domestic and foreign judicial practices. Various study methodologies, such as case analysis, synthesis and comparative methodology, were used during the paper.

Keywords: *beyond reasonable doubt, inner conviction, indications, fair trial, value of evidence, presumption of innocence.*

1. Rëndësia e parimit të provimit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Ky parim paraqet një rëndësi thelbësore për garantimin e procesit të rregullt ligjor, si një e drejtë thelbësore për garantimin e të drejtave të tjera të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si edhe nga aktet kryesore ndërkombëtare. Akti kryesor në aspektin ndërkombëtar është pikërisht Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka fuqi të njëjtë juridike në rast kufizimi të të drejtave themelore të sanksionuara prej saj. Procesi i të provuarit të fajësisë është një proces i vështirë dhe i ndërlikuar, sepse implikon një sërë konceptesh dhe institutesh të tjera të së drejtës si p.sh, prezumimi i pafajësisë, proces i çmuarjes së provave, bindja e gjyqtarit, pavlefshmëri dhe papërdorshmëri provash, etj. Procesi i rregullt ligjor trajtohet nga KEDNJ në dy aspekte, atë civil dhe atë penal, duke siguruar kështu një kuadër specifik dhe të detajuar lidhur me elementët kryesorë të këtij parimi. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka elaboruar dhe interpretuar rëndësinë që paraqet standarti “*tej çdo dyshimi të arsyeshëm*” për garantimin e një procesi ligjor të rregullt.

Parimi bazë kushtetues që siguron garantimin e një procesi të rregullt ligjor është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, në drejtim të respektimit të një aspekti shumë të rëndësishëm për garantimin e një procesi të rregullt ligjor, siç është e drejta për t’u mbrojtur. Në çështjen **Bykov kundër Rusisë**, GJEDNJ-ja ka theksuar se për të përcaktuar nëse procedura ka qenë e rregullt në tërësinë e saj, duhet të shtrohet gjithashtu pyetja nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Konkretisht, duhet të kërkohej nëse paditësit i është ofruar mundësia për ta vënë sërish në pikëpyetje vërtetësinë e provës dhe për ta kundërshtuar përdorimin e saj. Duhet të merret gjithashtu parasysh cilësia e provës, duke përfshirë edhe pikën nëse rrethanat në të cilat është mbledhur ajo ngjallin dyshime rreth besueshmërisë e saktësisë së saj (Jalloh k. Gjermanisë [DhM], § 96).¹

Standarti i të provuarit të fajësisë “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” është një gur themeli në të gjitha sistemet juridike në të gjithë botën. Kjo rëndësi shfaqet në disa elementë kryesorë siç mund të jetë

1 **Bykov k. Rusisë** [DhM], Aplikimi nr. [4378/02](#), gjykim i datës 10 mars 2009, §89.

iplikimi i parimeve juridike të mirënjohura si p.sh, prezumimi i pafajësisë. Jurisprudenca kushtetuese² ka theksuar se: “...prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Presumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuzat (Shih vendimet nr. 23, datë 23.07.2009, dhe nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese).”³

Për këto arsye jemi të mendimit se parimi i prezumimit të pafajësisë është para së gjithash një garanci procedurale gjatë procesit penal. Nëse prova përcjell dy interpretime të arsyeshme, gjykata duhet të aplikojë atë interpretim që është në pajtim me pafajësinë e të pandehurit. Nëse kemi të bëjmë vetëm me një interpretim, atëherë gjykata duhet të pranojë atë interpretim duke e konsideruar së bashku me faktet dhe provat e tjera. Ky konkluzion bazohet tek dispozitat e Kodit të Procedurës Penale i cili sanksionon në nenin 4 paragrafi i parë që: “...çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”

Kur flasim për proces penal nuk nënkuptojmë vetëm gjykatat penale që përcaktojnë akuzën por edhe organet e tjera që marrin pjesë në mënyrë aktive për të vërtetuar këtë akuzë. Të gjithë këto hallka duhet të zbatojnë në mënyrë rigoroze parimin e prezumimit të pafajësisë. Ky parim çenohet në rast se vendimmarrje të tjera lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një veprë penale pasqyron një paragjykim se ai është fajtor, pavarësisht se fajësia e tij nuk është provuar ende me një vendim penal të formës së prerë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ, duke konstatuar shkelje edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal të fajësisë së të pandehurit, por mjafton që të ketë një arsyetim që lë vend për të menduar se gjyqtari e konsideron të interesuarin si fajtor (*Minelli k. Zvicrës*).⁴ Nëse kemi të bëjmë me një situatë të tillë, atëherë mund të shtrohet për diskutim edhe një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm për një proces të rregullt ligjor, siç është paanshmëria në dukje e gjykatës. Sigurisht për vlerësimin dhe përcaktimin nëse gjykata ka shkelur parimin e paanshmërisë është tejet e vështirë, sidomos nëse vlerësimi bazohet vetëm në kriterin subjektiv. Kriteri objektiv shërben si një garanci shtesë që e zgjidh këtë situatë të ndërlikuar dhe problematike. Në çështjen *Kyprianou k. Qipros*⁵ gjykata e pranon vështirësinë e vërtetimit të ekzistencës së një shkeljeje të nenit 6 për anshmëri subjektive, prandaj ajo e bazon vendimmarrjen e saj tek kriteri objektiv i paanshmërisë.

Standarti i të provuarit të fajësisë “tej çdo dyshimi të arsyeshëm” paraqet një rëndësi akoma më të madhe për drejtësinë penale për shkak të rolit që ka në parandalimin e vendimmarrjeve të padrejta dhe për të ruajtur besueshmërinë e publikun tek sistemi i drejtësisë. Në thelb të drejtësisë penale qëndron një konflikt i vazhdueshëm interesash: balancimi i nevojës për të mos lënë pa dënim fajtorët dhe detyrimi për t’u ofruar mbrojtje të pafajshmëve. Ky standart shërben si një garanci efektive që privimi i lirisë personale të mos jetë i padrejtë dhe arbitrar. Pra, dënimet penale mund të shkaktojnë një sërë pasojash, të cilat përfshijnë cënimin e lirisë personale. Liria është një e drejtë themelore kushtetuese, të cilën e gjejmë si aspekt përbërës të çdo të drejte të njohur nga Kushtetuta si dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Dënimi penal është pikërisht rast kufizimi i kësaj të drejte dhe ky kufizim duhet të përmbushë kushtet e përcaktuara në KEDNJ. Por në rastin e privimit të lirisë në kuadër

2 *Vendim nr. 47, datë 07.11.2011* i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

3 Shih edhe, *Vendimi nr. 57, datë 21.12.2012* i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

4 *Minelli k. Zvicrës*, Aplikimi nr. 8660/79 gjykim i datës 25 mars 1983.

5 *Kyprianou k. Qipros*, Aplikimi nr. 73797/01, gjykim i datës 15 dhjetor 2005.

të drejtësisë penale, kemi disa kushte specifike dhe më të detajuara siç është edhe krijimi i bindjes “tejtë dyshimi të arsyeshëm”. Krijimi i bindjes së gjyqtarit dhe kuptimi i termit “tejtë dyshimi të arsyeshëm” do të trajtohet në mënyrë të detajuar dhe të arsyetuar në vijim të këtij punimi. Në këtë moment do të evidentohet vetëm rëndësia që ka ky parim gjatë procesit të zbulimit dhe të provuarit të vërtetës, si një nga qëllimet kryesore të drejtësisë penale.

Kuptimi dhe zbatimi i drejtë në praktikë i parimit të prezumimit të pafajësisë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sepse ky parim detyron akuzën që të provojë fajësinë e të pandehurit, e çliron këtë të fundit nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtë të zgjedhë mbrojtjen më të përshtatshme për të, të bëjë ose jo deklaramë, të kërkojë prova dhe të marrë pjesë aktivisht në shqyrtimin e tyre, duke kërkuar që provat e dyshimta të interpretohen gjithmonë në favorin e tij.

Gjithë bota po preket nga zhvillimet e mëtejshme teknologjike, të cilat ndikojnë në elementët dhe institutet më kyçe të së drejtës, siç është edhe koncepti “tejtë dyshimi të arsyeshëm”. Ndryshimet e fundit teknologjike kanë shtuar rëndësinë e trajtimit të këtij koncepti. Metodat e ndryshme mashtruese kanë bërë të mundur që gjykata të ketë vështirësi akoma më të mëdha për krijimin e bindjes së saj dhe arritjen e standartit të përcaktuar nga ligji

II. Procesi i marrjes dhe çmuarjes së provave.

Neni 149 i Kodit të Procedurës Penal ka dhënë kuptimin e provës, duke përcaktuar që: *“Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar: kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.”* Provat nuk kanë vlerë të paracaktuar, por gjatë procesit të vlerësimit të tyre disa prej tyre, paraqesin siguri dhe vlefshmëri për të arritur standartin më të lartë të të provuarit. Një detyrë shumë e rëndësishme e drejtësisë penale është marrja dhe çmuarja e provës, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionin ligjor të procedurës penale, që është zhvillimi i një gjykimi të drejtë e të rregullt, të zbulimit dhe të provuarit të së vërtetës.

Gjykata e Lartë⁶ është shprehur se: *“Përcaktimi i vërtetësisë së provës që është vënë si kusht nga ligjvënësi për të patur një proces ligjor çmuarje të saj, nënkupton...verifikimi se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çdo gjykim konkret, të cilin e përbëjnë përgjigjet që duhet t’u japë gjykata pyetjeve të tilla si: çfarë ka ndodhur, ku dhe kur ka ndodhur, me ç’mjet është kryer, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer veprën, përgjigje, të cilat duhet të përbëjnë shtratin mbi të cilin duhet ndërtuar pjesa arsyetuese e çdo vendimi gjyqësor në procesin penal”*. Gjithashtu nëpërmjet një vendimi⁷ tjetër është shprehur se: *“Procesi i të provuarit (...) është vërtetimi i fakteve nëpërmjet grumbullimit të provave të mjaftueshme për të bindur gjykatën lidhur me fajësinë e tij (të pandehurit) (...)”*.

Faktet objekt akuze duhet të provohen nga organi i prokurorisë, si organi që ka barrën e provës, i cili nëpërmjet provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, duhet t’i krijojë gjykatës bindjen “tejtë dyshimi të arsyeshëm”, se figura e veprës penale është konsumuar dhe se ajo është kryer nga personi i pandehur. Bazuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Është detyrimi i organit të akuzës që bashkë me dërgimin e një çështjeje për gjykim të paraqesë edhe provat mbi të cilat e mbështet akuzën.

6 **Vendimi nr. 25, datë 15.01.2003**, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

7 **Vendimi nr. 205, datë 06.04.2005** Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Kështu, në vendimin Nr. 196, datë 12.06.2013 Kolegji Penal i Gjykatës Lartë, ndër të tjera shprehet: *“Një konkluzion i tillë i këtij Kolegji bazohet në nenin 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar dhe duhet t’i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Kjo do të thotë se fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme, e pa mbështetur kjo me prova të tjera më tepër kur ajo nuk provon qartësisht fajësinë e të gjykuarve. Nëse do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë kësaj prove do t’i jepej vlerë e paracaktuar, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këtë rast nuk do të kishim çmuarje të provave, gjë që është kërkesë e detyrueshme kësaj dispozite.”*

Nevoja e ekzistencës së pluralitetit të provave është shprehur edhe në vendimin nr. 135, datë 19.03.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku gjykata ka arritur në përfundimin se: *“Pa trajtuar për rastin në shqyrtim analizën e provave, ky kolegji arrin në përfundimin se gjykatat nuk kanë mundur të marrin prova që të vërtetohet ekzistenca e faktit, gjë që i bën vendimet e tyre të cënueshme. Ato u referohen vetëm deklarimeve të bëra nga i dëmtuari, të cilat nuk mbështeten në të dhëna të tjera që ta bëjnë të pranueshme ekzistencën në veprimet e të pandehurit të kryerjes së veprës penale për të cilën është akuzuar”.*

Më tej në po të njëjtin vendim gjykata shprehet se: *“Do të ishte gabim për çdo gjykatë e aq më tepër për Gjykatën e Lartë, që të pranonte e të deklaronte fajtor një person e për një vepër kaq të rëndë, vetëm me deklaratimet e të dëmtuarit të pa harmonizuara me prova apo me indicje të tjera, sikurse kërkon ligji. Pranimi i të kundërtës do t’i hapte rrugë një arbitrariteti me pasojë shkeljen e të drejtave të individit në procesin penal dhe që pa prova, individë të akuzuar për kryerjen e veprave penale të deklarohen fajtorë e të vuajnë një dënim të padrejtë”.*

Gjithashtu, lidhur me këtë aspekt, GjEDNj në çështjen Al-Khawaja e Tahery k. Mbretërisë së Bashkuar ka mbajtur qëndrimin se: *“Në qoftë se një dënim bazohet vetëm, ose në një masë përcaktuese, mbi deponime të bëra nga një person të cilin i akuzuari nuk ka mundur ta marrë në pyetje ose të kërkojë të merret në pyetje, as në fazën e hetimit, as gjatë debateve, atëherë të drejtat e mbrojtjes mund të gjenden të kufizuara në një mënyrë të papajtueshme me garancitë e nenit 6 (rregulli i proves së vetme ose përcaktuese)”.*

Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme, e cila nuk lidhet me prova të tjera. Në mënyrë sintetizuese, mund të theksojmë se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka orientuar gjykatat më të ulëta që, në arsyetimet e tyre, t’u përshtaten rregullave vijuese:

- a) një provë e vetme, e palidhur me prova apo indicje shtesë, nuk mund të vlejë për të provuar fajësinë e të pandehurit në procesin penal. Për zbatimin e këtij rregulli, Kolegji nuk bën dallim midis provës së drejtpërdrejtë dhe provës së tërthortë (*indicjes*);
- b) deklarimi fajtor i personit të akuzuar, bazuar në një provë të vetme, i jep asaj *“vlerë të paracaktuar”*; kjo vjen ndesh me rregullin që parashikon neni 152/1 dhe me parimin e çmuarjes së dyshimeve në favor të të pandehurit, sikundër normon neni 4 i KPP;
- c) posaçërisht, në rastin e përgjimeve telefonike, edhe pse mund të jenë kapur dhe regjistruar shumë biseda, ato quhen një provë e vetme, që duhet t’iu nënshtrohet rregullave *“a”* dhe *“b”*.

Vlen për t’u përmendur që procesi i çmuarjes së provave është proces **i ndërlikuar dhe kompleks**,

pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që medoemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K. Pr. Penale. Për këtë arsye, gjykatës i shtrohet detyra për të bërë një analizë të plotë dhe të hollësishme të provave, në tërësi e tyre, pa i dhënë asnjërës vlerë të paracaktuar, ashtu siç parashikohet në nenin 152 të K.Pr.Penale, këtë mënyrë vendimi do të jetë rezultat i një hetimi të plotë e të gjithanshëm mbështetur në ligjin material dhe procedural penal.

III. Bindja e brendshme e gjyqtarit

Për të kuptuar sistemin e çmuarjes së provave të mbështetur në bindjen e brendshme të gjykatës, është e nevojshme të sqarohet se ai pasoi *sistemin primitiv* dhe *sistemin e provave ligjore (formale)* Sistemi primitiv ose sistemi i provave të procedurës akuzatore zë fill në demokracinë e Athinës. Ai u zhvillua edhe në institucionet gjyqësore të Romës së vjetër, në periudhën republikane. Në sistemet klasike të procedurës akuzatore, veprimtaria gjyqësore mbështetej në nismën e palëve, akuza private dhe mbrojtja gëzonin barazi të plotë, institucioni i akuzës publike nuk njihej.⁸ (Ligori, 2019)

Ndërsa sipas *sistemit të provave ligjore (formale)*, në të cilin llojet e provave dhe fuqia e tyre provuese caktoheshin me ligj. Ky sistem u ndërtua, duke filluar nga fundi i shek. XI, me qëllimin për të kufizuar arbitraritetin e gjyqtarëve, të cilët ishin të detyruar t'i çmonin provat sipas fuqisë që u kishte paracaktuar ligjvënësi. Në sistemin e provave ligjore parashikohej klasifikim i hollësishëm i mjeteve të provës dhe i vlerës së tyre provuese. Një dëshmitar i vetëm nuk mund të provonte asgjë, sipas formulës së njohur, të shprehur në latinishte, *unus testis, nullus testis*. Pohimi i të akuzuarit konsiderohej “mbretëresha e provave”, për nxjerrjen e tij lejohej edhe tortura, e cila përdorej në shkallë të gjerë, sidomos gjatë ballafaqimeve me dëshmitarët e vetëm. Në këtë sistem flitej edhe për gjysmë prove, për një çerek prove, etj., të cilat gjyqtari duhej t'i mblidhte në mënyrë aritmetike, sipas rregullave të paracaktuara nga ligjvënësi. Ky sistem ishte shumë i ngurtë, mekanik, i bazuar në llogaritje tarifore të provave, i cili nuk i lejonte gjyqtarit asnjë lloj gjykimi sipas ndërgjegjes së vlerësimit të lirë të fakteve gjatë gjykimit, ndaj nuk mundi t'u qëndronte dot filozofisë së iluminizmit dhe të racionalizmit të shek. XVII-XVIII. Ai u zëvendësua nga një sistem tjetër, ku provat nuk kishin më vlerë të paracaktuar nga ligjvënësi dhe çmuarja e tyre tashmë do të mbështetej në parimin e bindjes së lirë të gjyqtarit.⁹ Sistemi i provave ligjore ose formale në Francë vazhdoi të ekzistonte deri në vitin 1791, kur u shfuqizua nga Asambleja Kushtetuese. Vendimmarrja iu besua gjyqtarëve me formim teknik në fushën e ligjeve. Por, ka rëndësi të theksohet se sistemi i provave ligjore mori fund njëherë e përgjithmonë dhe çmuarja e provave, tash e tutje, do të mbështetej në parimin e bindjes së lirë të gjyqtarit¹⁰

Legjislacioni penal shqiptar ka sanksionuar që provat merren prej burimeve të parashikuara nga ligji, duke përcaktuar kështu parimin e taksativitetit të mjeteve të të provuarit. Nëpërmjet interpretimit lateral të normës, mund të konkludojmë që provimi i fakteve gjatë procesit penal mund të bëhet vetëm nëpërmjet burimeve të parashikuara nga ligji. Për këtë arsye pushteti legjislativ në nenin 8/a, par.1 dhe 149, par.2, ka parashikuar edhe parimin e lirisë së provave, në këtë mënyrë ka përzgjedhur që këto dy parime të bashkëveprojnë në funksion të realizimit të qëllimit final, atë të dhënies së drejtësisë. Doktrina i njeh si prova atipike. Sistemi jonë i drejtësisë penale ndërtohet mbi parimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit në çmuarjen e provave. Sipas këtij parimi nuk pranohet hierarkia e provave, ndaj, prova nuk kanë vlerë të paracaktuar, në raport me provat e tjera. Provat vlerësohen në tërësinë e tyre dhe gjyqtari është i lirë në krijimin e bindjes së tij, të pandikuar nga rrethana dhe faktorë të jashtëm. Ky sistem aplikohet si për përcaktimin e fajësisë, po ashtu edhe në drejtim të pafajësisë së

8 Henrik Ligori, *Për problemin e provës së vetme*, “Jeta Juridike”, nr.4/2013.

9 Po aty,

10 Po aty

personit të pandehur. Çdo provë duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, dhe çmuarja e tyre të bëhet mbi bazën e bindjes së brendshme, duke arsyetuar logjikën ku mbështetet bindja e formuar.

IV. Vështirim krahasimor lidhur me standartin e të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm

Standardi i të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ka evoluar dhe është maturuar që nga fillimi i ekzistencës së tij në sistemet common law disa shekuj më parë. Në sistemet common law, gjyqtari udhëzon dhe u jep orientime anëtarëve të jurisë gjatë gjithë gjykimit. Gjyqtari duhet ta bëjë të qartë në këto udhëzime që anëtarët e jurisë duhet t'i japin “*përfitim e dyshimit*” të akuzuarit. Nëse ka ndonjë dyshim të arsyeshëm nga tërësia e provave, juria duhet të vendosë për pafajësinë e të akuzuarit. Disa gjyqtarë udhëzojnë anëtarët e jurisë se një dyshim i arsyeshëm është “*një dyshim i bazuar në arsye*”¹¹.

Një shpjegim tjetër i zakonshëm, referuar praktikës amerikane, është se provat duhet t'i bindin anëtarët e jurisë për fajin “*për një siguri morale*”. Disa gjykata federale e kanë hedhur poshtë në mënyrë eksplicite standardin e “*sigurisë morale*”, duke u druajtur se fjala “*siguri*” do të binte ndesh me konceptin e “*dyshimit të arsyeshëm*”¹², megjithëse disa gjykata shtetërore e mbështesin atë.¹³

Gjykata Supreme e SHBA-së ka thënë se ajo “*nuk e pranon përdorimin e frazës së vjetëruar të sigurisë morale*”, por e ka lejuar atë kur përforcohet me një gjuhë gjoja sqaruese¹⁴. Është interesante se standardi i “*sigurisë morale*” fillimisht u prezantua me nxitjen e prokurorëve për të pakësuar barrën e tyre, sepse “*siguria morale*” mendohej si “*siguri e arsyeshme*”, në krahasim me “*sigurinë absolute*” që ata dreheshin se anëtarët e jurisë kërkonin.

Sot, standardi i të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm është i përhapur gjerësisht edhe në sistemet civil law. Si të tilla, shumë sisteme të drejtësisë penale në të gjithë Evropën kërkojnë nga prokuroria të provojë fajësinë e të pandehurit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ose me siguri të lartë, në të kundërt, i pandehuri do të përfitojë pafajësinë.

Në Gjermani dënimi i gjyqtarit për fajësinë e të pandehurit “*duhet të jetë subjektiv dhe duhet të bazohet në faktorë bindës, të cilët nuk lënë vend për dyshime të arsyeshme*”. Pavarësisht se përbën një rregull të gjithë pranuar botërisht, ai nuk përmendet në Kodin e Procedurës Penale të Gjermanisë dhe Gjykata Kushtetuese Federale (Bundesverfassungsgericht) deri më tani ka lënë të hapur nëse ky parim gëzon një mbrojtje kushtetuese¹⁵.

Në Itali, kur i referohet vendimit të dënimit, Kodi i Procedurës Italiane¹⁶ thekson se: “*Gjyqtari shpall*

11 *Shtetet e Bashkuara k. Johnson*, 343 U.S. 5, 6 n.1 (2d Cir. 1965); *Jackson k. Virginia*, 443 U.S. 307, 317 n.9 (1979).

12 *Shih Shtetet e Bashkuara k. Byrd*, 352 F.2d 570, 575 (2d Cir. 1965); *shih gjithashtu Shtetet e Bashkuara k. Indorato*, 628 F.2d 711, 720–21 (1st Cir. 1980).

13 *People k. Sims*, 853 P.2d 992, 1024 (Cal. 1993); *People k. Wong*, 619 NE2d 377, 381 (NY 1993); *People k. Dahlin*, 539 NE 2d 1293, 1296 (Ill. App. Ct. 1989).

14 *Victor k. Nebraska*, 511 US 1, 16 (1994).

15 *Gjykata Kushtetuese Federale (Bundesverfassungsgericht)*, Karlsruhe/2 BvR 814/87, 23 Shtator 1987.

16 Neni 533/1 i Kodit të Procedurës Penale të Italisë.

dënimin nëse i akuzuari shpallet fajtor për veprën e akuzuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”.

Lidhur me standartin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, Gjykata e Kasacionit të Italisë, ka mbajtur qëndrimi se: “Ky standart kërkon që gjyqtari të përdorë “një metodë dialektike të verifikimit të hipotezës akuzuese sipas kriterit të dyshimit, me pasojë që gjyqtari duhet të kryejë verifikimin në fjalë në mënyrë të tillë që të shmangë ekzistencën e dyshimeve të brendshme”. (d.m.th. vetëkontradiktore ose paafërsia e tij shpjeguese) ose e jashtme ndaj saj (d.m.th. ekzistenca e një hipoteze alternative të pajisur me racionalitet dhe besueshmëri praktike)”.¹⁷

V. Çfarë kuptojmë me termin “tej çdo dyshimi të arsyeshëm”?

Analiza e mësipërme na shërben për t’i dhënë kuptimin e duhur konceptit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” do të thotë se provat e paraqitura dhe argumentet e paraqitura nga prokuroria vërtetojnë fajësinë e të pandehurit aq qartë sa duhet të pranohen si fakt nga çdo person racional. Nëse gjykata nuk mund të thotë me siguri bazuar në provat e paraqitura se i pandehuri është fajtor, atëherë ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe ajo është e detyruar të japë një vendim pafajësie.

Standarti i të provuarit të fajësisë “përtej dyshimit të arsyeshëm” luan një rol të domosdoshëm në sistemin amerikan të procesit penal, sepse qëllimi i këtij standarti është dhënia e “*substancës konkrete*” për t’u siguruar kundër dënimeve të padrejta dhe për të zvogëluar rrezikun e gabimit faktik në procedimet penale.¹⁸ (Hon. James A. Shapiro, & Karl T. Muth, 2021). Sistemi gjyqësor në të gjithë botën dhe doktrinalistë të shumtë janë përpjekur të japin një përkufizim të saktë lidhur me termin “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por asnjëherë nuk është arritur dakortësia për t’i dhënë një përkufizim. Gjyqtari është personi kompetent dhe i detyruar, që në bazë të provave të paraqitura, t’i çmojë dhe të krijë bindjen sipas standartit të kërkuar nga ligjvënësi. Gjyqtari ka barrën për të arsyetuar si është arritur ky standart, dhe të shpjegojë në mënyrë të detajuar çdo faktor që ka ndikuar për krijimin e bindjes së tij. Nëpërmjet këtij punimi po argumentojmë që standarti “tej çdo dyshimi të arsyeshëm” nuk duhet të ketë një përkufizim strikt dhe të gjithëpranuar, sepse nuk kemi të bëjmë me një të tillë. “Përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” është një koncept, si i tillë udhëhiqet nga një sërë parimesh të mirënjohura në fushën e së drejtës. Përkufizimi i tij do të kufizonte gjykatën dhe do ta cungonte bindjen e brendshme dhe të lirë të gjykatës.

VI. Përfundime

Parimi i të provuarit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm është thelbësor për garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe për mbrojtjen e të drejtave të individit në sistemin penal. Ai siguron që askush të mos dënohet pa prova të mjaftueshme dhe të besueshme, duke mbrojtur kështu individët nga dënimet e padrejta. Organet e drejtësisë penale duhet të zbatojnë në mënyrë rigorozë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe standardin “tej çdo dyshimi të arsyeshëm” për të siguruar një proces të drejtë dhe të paanshëm. Çdo fazë e procedurës penale duhet të përshkruhet nga zbatimi i këtij parimi.

Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të trajnohen dhe të edukohen mbi rëndësinë e këtij parimi, dhe çfarë është më e rëndësishmja, mbi mënyrën e zbatimit të tij në praktikë. Njohja dhe zbatimi i duhur i këtij standardi do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së standardeve gjyqësore. Zgjidhja nuk është dhënia e një përkufizimi të termit “tej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por krijimi i me-

¹⁷ shih, *Kasacioni Penal*, seksioni I, 24 tetor 2011, nr. 41110.

¹⁸ Hon. James A. Shapiro, & Karl T. Muth, *Beyond a Reasonable Doubt: Juries Don’t Get It*, 52 Loy. U. Chi. L. J. 1029 (2021).

kanizmave për monitorimin e zbatimit në praktikë të këtij parimi. Këto mekanizma do të ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i eksperiencave me vendet e tjera mund të ndihmojë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale. Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që kërkon ndërhyrje legjislative është paketa e të drejtave që kanë të akuzuarit dhe garantimi efektiv i tyre nga organet ligj zbatuese. Përdorimi i provave shkencore dhe teknologjike të avancuara duhet të promovohet për të siguruar që procesi i zbulimit të së vërtetës realizohet sipas standardit të kërkuar. Në këtë mënyrë vendimet bazohen në prova të besueshme dhe objektive. Ky punim nëpërmjet trajtimit të jurisprudencës shqiptare dhe të huaj synon të hedhë dritë mbi mënyrën e perceptimit nga ana e gjykatave të koncepteve kyçe gjatë vendimmarrjes së tyre. Ruajtja e integritetit të sistemit penal është sfida që kanë organet e drejtësisë.

Si përfundim, parimi i të provuarit të fajësisë “tej çdo dyshimi të arsyeshëm” është një element kyç i drejtësisë penale, i cili mbështetet nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe nga jurisprudenca dhe doktrina përkatëse. Zbatimi i duhur i këtij parimi garanton mbrojtjen e të drejtave të individëve nga vendimet arbitrare, si dhe rrit besueshmërinë në sistemin e drejtësisë.

Referenca

1. *Jurisprudencë shqiptare dhe e huaj*
2. *Bykov k. Ruse* [DhM], Aplikimi nr. [4378/02](#), gjykim i datës 10 mars 2009, §89.
3. *Gjykata Kushtetuese Federale (Bundesverfassungsgericht)*, Karlsruhe/2 BvR 814/87, 23 Shtator 1987.
4. *Jackson k. Virginia*, 443 U.S. 307, 317 n.9 (1979).
5. *Kyprianou k. Qipros*, Aplikimi nr. [73797/01](#), gjykim i datës 15 dhjetor 2005.
6. *Minelli k. Zvicrës*, Aplikimi nr. 8660/79 gjykim i datës 25 mars 1983.
7. *People k. Dahlin*, 539 NE 2d 1293, 1296 (Ill. App. Ct. 1989).
8. *People k. Sims*, 853 P.2d 992, 1024 (Cal. 1993);
9. *People k. Wong*, 619 NE2d 377, 381 (NY 1993);
10. *Shtetet e Bashkuara k. Byrd*, 352 F.2d 570, 575 (2d Cir. 1965); *shih gjithashtu*
11. *Shtetet e Bashkuara k. Indorato*, 628 F.2d 711, 720–21 (1st Cir. 1980).
12. *Shtetet e Bashkuara k. Johnson*, 343 U.S. 5, 6 n.1 (2d Cir. 1965);
13. *Vendim nr. 47, datë 07.11.2011* i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
14. *Vendimi nr. 205, datë 06.04.2005* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
15. *Vendimi nr. 25, datë 15.01.2003*, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.
16. *Vendimi nr. 57, datë 21.12.2012* i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
17. *Victor k. Nebraska*, 511 US 1, 16 (1994).
18. *Literaturë*

19. **Komentari Elektronik** <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/>
20. **Ligori Henrik**, *Për problemin e provës së vetme*, “Jeta Juridike”, nr.4/2013.
21. **Shapiro, & Karl T. Muth**, *Beyond a Reasonable Doubt: Juries Don't Get It*, 52 Loy. U. Chi. L. J. 1029 (2021).
22. **Akte ligjore**
23. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
24. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
25. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë